



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT**

**V E N D I M**

Nr. 10, datë 27.04.2018

**P Ë R**

**MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:  
“NDËRTIM MAGAZINASH, SHOWROOM, ZYRA, RIKONSTRUKSION I OBJEKTEVE  
EKZISTUESE, SHITESË KATI DHE SHITESË ANËSORE”, BASHKIA VORË”**

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të shoqërisë “Kato Aromatik Albania” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Ndërtim magazinash, showroom, zyra, rikonstruksion i objekteve ekzistuese, shtesë kati dhe shtesë anësore”, Bashkia Vorë”, me subjekt zhvillues shoqërinë “Kato Aromatik Albania” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
  - a) plotësimit të dokumentacionit ligjor;
  - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, për llogari të Bashkisë Vorë.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**K R Y E T A R I**  
**E D I R A M A**



MINISTËR I LINJËS  
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË  
DAMIAN GJIKNURI



ANËTAR / SEKRETAR I KKT  
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT  
LEDIA TOTA

